MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË DELVINË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Bashkinë Delvinë me objekt: "Për vlerësimin e aktivitetit ekonomik e financiar, procedurat e shqyrtimit dhe të miratimit të studimeve urbanistike shesheve e lejeve të ndërtimit, lejeve të shfrytëzimit, administrimin e aseteve, vlerësimin për shitje të trojeve nën objekt, shitjen e trojeve, dhënien me qira të objekteve pronë publike, funksionimi i policisë bashkiake, vlerësimi i auditit të brendshëm etj" dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 59, datë 8.5.2012.
Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 151/5, datë 8.5.2012, dërguar **z. Dhurim Alinani**, Kryetar i Bashkisë, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Të merren masa që të rishikohet struktura e shpenzimeve të bashkisë me qëllim uljen e ndjeshme të fondit të pagave nëpërmjet shkurtimit të numrit të punonjësve dhe përdorimin e tyre në rritjen e investimeve, duke ruajtur një raport të arsyeshëm midis tyre, në favor të investimeve.

Vazhdimisht

2. Të bashkëpunohet me ZVRPP Sarandë për përfundimin e procesit të regjistrimit në emër të Bashkisë Delvinë, të gjitha pasurive të miratuara me VKM nr. 1256, datë 16.12.2009 "Miratim i listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Delvinë", si objekte ndërtimore, pyje, kullotat dhe livadhet etj, në bazë të nenit 6 të ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 "Për Pronat e Paluajtshme të Shtetit" dhe ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" i ndryshuar.

Menjëherë

3. Në përputhje me strukturën organike të miratuar, të plotësojë pozicionin e K/inspektorit të Policisë Bashkiake, vend vakant prej 2 vjetësh dhe të zëvendësojë auditin e brendshëm, i cili nuk është i certifikuar, në zbatim të nenin 19 të ligjit nr. 9720, datë 23.4.2007 "Për auditin e brendshëm në sektorin publik" i ndryshuar.

Për Drejtorinë e të ardhurave

1. Për objektet e biznesit të vogël, të saktësojë sipërfaqet ndërtimore të objekteve në përputhje me dokumentet e pronësisë dhe të matura nga komisionet e bashkisë.

Menjëherë

2. Taksa e tokës bujqësore të detajohet sipas bonitetit të saj dhe jo sipas fshatrave, në zbatim të nenit 21 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 i ndryshuar.

Menjëherë

3. Të evidentojë debitorët e vitit 2011 për taksën vendore të biznesit të vogël, duke vendosur penalitetet e parashikuara në nenet 4/2, 17/3, 34 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, i ndryshuar, deri në bllokimin e llogarive të tyre bankare në zbatim të nenit 90 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat tatimore", i ndryshuar.

Menjëherë

Për Auditin e brendshëm

1. Auditi i brendshëm të lerë gjurmën e auditimit në kontrollet e kryera, nëpërmjet dokumentimit me aktverifikime, procesverbale dhe projetkraportet përkatës, në zbatim të pikës 4/5 të Manualit auditimit dhe të ligjit nr. 10 296, datë 08.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin".
Në programet vjetore të parashikohen auditime performance.

Vazhdimisht

Për Inspektoratin Ndërtimor Urbanistik pranë Bashkisë

1. Për punimet e kryera pa leje ose në shkelje të kushteve të lejes, sipas ligjit, autoritetet e inspektimit, krahas dënimit për kundërvajtjet e konstatuara, ti kërkojnë kundërvajtësit të paraqesë pranë autoritetit përgjegjës të planifikimit, një kërkesë për pajisjen me leje të punimeve të paligjshme ose të kryera në shkelje të kushteve të lejes fillestare.

Vazhdimisht

2. Dhënia e lejeve të ndërtimit për punimet të kryera në kundërvajtje administrative, të bëhet pasi të jetë paguar më parë gjoba, në zbatim të ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009 "Për Planifikimin e Territorit" i ndryshuar.

Vazhdimisht

B. <u>MASA PËR SHPËRBLIM DËMI</u>

Të kërkohen në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit të shkaktuar buxhetit të bashkisë në vlerën **1,289,003 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, si më poshtë:

1. Për vlerën 804,843 lekë, dhënie bursa studimi, në kundërshtim me nenin 1 të VKM nr. 998, datë 30.09.2009 dhe VKM nr. 759, datë 15.09.2010 nga [redacted] me detyrë drejtore e Drejtorisë së Financës.

2. Për vlerën 225,000 lekë, dhënie shpërblimi nga fondi i veçantë për punonjësit e bashkisë në kundërshtim me pikën 1/c të VKM nr. 472, datë 2.07.2011 "Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore, për vitin 2011".

3. Për vlerën 259,160 lekë, për mosarkëtimin e detyrimeve kontraktuale nga katër subjekte, për objektet e bashkisë të dhëna me qira.

C. <u>MASA ADMINISTRATIVE</u>

Ti rekomandohet Agjencisë së Prokurimit Publik, që në zbatim të nenit 72 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 i ndryshuar dhe Kreut X të VKM nr. 1 datë 10.01.2007, të marrë masa administrative, për shkeljet e konstatuara në zhvillimin e procedurës së prokurimeve publike në vitin 2010, 2011 për personat e poshtëshënuar:

1. [redacted] në cilësinë e kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.
2. [redacted] në cilësinë anëtarit të KVO.
3. [redacted] në cilësinë e anëtarit të KVO, për shkak se në tenderin me objekt "Shtesë kati dhe sistemime në shkollën 9 vjeçare Kosta Çavo", me vlerë 19,537,246 lekë, kanë shpallur fitues [redacted] në kushtet që operatori fitues:

- Nuk ka në stafin e vet një ekonomiste me kontratë në kundërshtim me pikën 4.7/d të "Kushteve të veçanta të kontratës" (KVK) të DST të miratuara nga AK.
- Në aktmarrëveshjen lidhur midis palëve nuk janë përcaktuar elementët konkretë që duhet të kryejë secili anëtarët në kundërshtim me pikën 2/b "Bashkimi i operatorëve ekonomikë" të Kreu-t të VII "Kushte të përgjithshme për zbatim" të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 i ndryshuar, i cili përcakton se... grupi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohet përfaqësuesi i grupit... dhe elementët konkretë që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij grupi.
- Drejtuesit teknik të [redacted] në listë pagesat e kontributeve shoqërore dhe shëndetësore janë të regjistruar si punëtorë dhe janë paguar me pagë 18,000 lekë/muaj, kurse [redacted] nuk ka në listë pagesat e kontributeve të shoqërore dhe shëndetësore dy nga tre drejtuesit teknik që përmban licenca e shoqërisë, për gjithë periudhën e kërkuar në DST, në

kundërshtim me pikën 2/d të nenit 45 “Kriteret e përjashtimit të kandidatëve ose ofertuesve” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar, VKM nr. 285, datë 04.05.2007 “Për përcaktimin e pagës referuese mujore për efekt të llogaritjes së kontributeve...” dhe pikën 4.2.ç “Pjesëmarrja dhe kualifikimi” të DST të miratuar nga AK.
[redacted] në licencën e shoqërisë nuk ka kategoritë e punimeve NP-3B, NP-11, NS-8, NS-14 dhe NS-18 në kundërshtim me pikën 4.7.d të KVK të miratuara në DST.
Në dokumentacioni ligjor kualifikues të [redacted] dhe u konstatua se:
- Shoqëria [redacted] nuk ka paraqitur listë pagesën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit maj 2011 në **kundërshtim** me pikën 2/4 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” (KVK) të DST, të kërkuara nga AK.
- Për vitin 2010 nuk janë të siguruar drejtuesit teknik [redacted] kurse për vitin 2011për muajt janar, shkurt nuk është siguruar [redacted] në kundërshtim me pikën 2/d të nenit 45 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, dhe pikën 4.2.ç të DST të miratuar nga AK.
- Në aktmarrëveshjen lidhur midis shoqërive, nuk janë përcaktuar elementët konkretë që duhet të kryejë secili anëtarët në kundërshtim me pikën 2/b “Bashkimi i operatorëve ekonomikë” të Kreu-t të VII “Kushte të përgjithshme për zbatim” të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 i ndryshuar.
Në këtë situatë, kur të gjithë OE s’kualifikohen, AK mbështetur në pikën 1/b “Mungesa e konkurrencës” të Kreu-t VII “Kushte të përgjithshme për zbatim” të VKM nr. 1, datë 10.01.2007, duhet të fillonte një procedurë të re tenderimi.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Fatmir Zilja dhe Josif Lile. Më tej u shqyrtua nga Kryeauditues i Departamentit Miranda Haxhia, Drejtori i Departamentit Pullumb Beqiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Elvana Tivari, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm Helga Vukaj.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT